



Funded by
the European Union



UDHËZUES PËR TRAJNERË MODULI 5:

PËRFSHIRJA E MËSIMIT AKTIV NË PRAKTIKËN PEDAGOGJIKE



Projekti “Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë”

Informata të përgjithshme:

Me të gjitha trajnimet e mësimdhënësve në shkollë, është më mirë nëse punëtorja i përshtatet nevojave individuale të shkollës.

Materialet për këtë punëtori janë krijuar për ta ndihmuar trajnerin që ta zhvillojë një punëtori efektive, por mënyra ideale do të ishte që materialet të individualizohen për kontekstin specifik.

Nuk ka ndonjë kohë specifike për aktivitetet në punëtori. Sugjerohet që punëtorja të realizohet brenda një dite. (Përafërsisht 5 orë) Punëtorja mund të zgjatet për një periudhë më të gjatë ose të ndahet në një seri punëtorish të shkurtra.

Aktivitetet e mëposhtme mund të zhvillohen në punëtori individuale

- o Aktiviteti i vlerësimit me rubrikë
- o Të shkruarit e definicionit të mësimdhënies dhe mësim-nxënies së cilësisë së lartë.
- o Rishikimi i teksteve shkollore
- o Aktiviteti për realizimin e vetë-studimit të shkollës.

Punëtorja mund të zhvillohet edhe në formën pa letër. Përndryshe, nëse është e nevojshme duhet të përgatitet një broshurë me materiale të punëtorisë.

Në udhëzuesin e punëtorisë, personi që e zhvillon punëtorinë quhet trajner dhe personat në punëtori quhen pjesëmarrës.

Punëtorja mund të zhvillohet edhe nga një ekip i trajnerëve, nëse dëshironi.

Nuk ka kufizime për sa i përket numrit të pjesëmarrësve në punëtori, por preferohet që të jenë më pak se 30 pjesëmarrës.

Detyrat para punëtorisë

1. Trajneri duhet të vendosë për kohëzgjatjen e punëtorisë/ve dhe të përgatitet sipas rrethanave.
2. Trajneri duhet të vendosë për kohën e secilit aktivitet.
3. Trajneri duhet t'i printojë materialet e punëtorisë për pjesëmarrësit nëse është e nevojshme. Trajneri mund të vendosë që t'i printojë materialet vetëm për një ose dy nga aktivitetet.
4. Trajneri duhet të kërkojë nga pjesëmarrësit që të sjellin në punëtori kopjet e planifikimit të tyre.
5. Trajneri duhet të kërkojë nga pjesëmarrësit që t'i sjellin tekstet shkollore që i përdorin rregullisht.
6. Trajneri duhet ta shqyrtojë fjalorthin e termave në mënyrë që ai/ajo ta kuptojë terminologjinë.
7. Trajneri duhet ta rregullojë sallën në mënyrë që rreth secilës tavolinë të ulën 4/6 pjesëmarrës.
8. Trajneri duhet të kontrollojë nëse punësia mund të zhvillohet duke e përdorur projektoren. (Nëse projektori nuk funksionon, pjesëmarrësit duhet t'i kenë prezantimet e printuara.)

Fjalor i termeve

Vlerësimi mirënjohës është kur një mësimitdhënës përdor shenja, nota të thjeshta ose korigjime (10/10), një vulë dhe/ose komente të shkurtra të bazuara në arritje. (Te lumtë! Punë e mirë!)

Diferencimi i përmbajtjes nënkupton përdorimin e formateve të ndryshme gjatë mësimitdhënies si video, tekste, ligjërata ose audio.

Diferencimi sipas produktit do të thotë që mësimitdhënësit i vlerësojnë të njëjtat njohuri ose shkathtësi të secilit nxënës, por ata u ofrojnë nxënësve të tyre mënyra të ndryshme për t'i demonstruar njohuritë e tyre (p.sh. video, raport me shkrim, prezantim).

Diferencimi sipas procesit, do të thotë se mësimitdhënësit ua mësojnë secilit nxënës të njëjtin koncept ose shkathtësi, por ata e ndryshojnë mënyrën se si e ligjërojnë atë. Nxënësit mund të punojnë në çifte ose grupe, të përdorin teknologjinë, të përdorin objekte për t'u ndihmuar atyre që ta kuptojnë një koncept.

Diferencimi i mjedisit mësimor do të thotë se mësimitdhënësi bën ndryshime ose në mjedisin fizik ose në atmosferën në të cilën punojnë nxënësit. (p.sh., duke luajtur muzikë relaksuese, duke i lejuar nxënësit të punojnë vetëm ose në grupe)

Informatat kthyesë mund të jenë me shkrim ose me gojë. Këto janë informata që u jepen nxënësve nga mësimitdhënësi lidhur me performancën e tyre. (Notimi i nxënësve me 1,2,3,4,5 nuk është informatë kthyesë)

Vlerësimet formative: përdoren për të informuar procesin e mësimitdhënies dhe të nxënësve. Ato i identifikojnë konceptet e gabuara, dhe boshllëqet në mësimitdhënien, dhe e përmirësojnë mësimitdhënien si dhe të nxënësve. Për shembull: kuizet, reflektimet në klasë, përdorimi i pyetjeve përforcuese, anketave, punën në grupe.

Vlerësimi formativ i ciklit të gjatë: Të arriturat e nxënësve monitorohen nëpër njësi mësimore. Cikli mund të zgjas nga 4 javë deri në 1 vit. Të dhënat përdoren për ta përafëruar kurrikulën, për ta monitoruar mësimitdhënien e kurrikulës dhe për t'i monitoruar të arriturat e nxënësve për një periudhë më të gjatë kohore. Për shembull: Vlerësimi në fund të semestrit. Vlerësimi në fund të vitit.

Vlerësimi formativ i ciklit të mesëm: Ky vlerësim bëhet në fund të një faze të të nxënësve.

Kjo bëhet çdo 1 deri në 4 javë. Për shembull: Një shkrim i vlerësuar i cili është kulmi i tre javëve të punës. Një test matematike pas dy javësh mësimi për thyesat.

Fjalor i termeve

Vlerësimi formativ i ciklit të mesëm: Ky vlerësim bëhet në fund të një faze të të nxënësve.

Kjo bëhet çdo 1 deri në 4 javë. Për shembull: Një shkrim i vlerësuar i cili është kulmi i tre javëve të punës. Një test matematike pas dy javësh mësimi për thyesat.

Vlerësimi formativ i ciklit të shkurtër: Një fjalë tjetër për këtë është 'mësimdhënia reaguese.' Ky vlerësim bëhet gjatë një ore mësimore ose ndërmjet orëve mësimore. Mësimdhënësi reagon ndaj të dhënave të mbledhura në orën e mësimi dhe e përshtat mësimdhënien në përputhje me rrethanat. Për shembull: Pyetjet përforcuese, vëzhgimi nga mësimdhënësi, kuizet, përgjigjja në një pyetje në tabela të bardha individuale ose në copëza letre.

Pyetja përforcuese është një kontroll kyç për të kuptuar në thelb një njësi mësimore që është kritike për t'u kuptuar nga nxënësit. Çdo nxënës duhet t'i përgjigjet pyetjes brenda dy minutave. Mësimdhënësi duhet të jetë në gjendje t'i mbledhë dhe interpretojë përgjigjet nga të gjithë nxënësit brenda 30 sekondave dhe të vendosë se si të vazhdojë me njësinë mësimore.

Meta-njohja ka të bëjë me mënyrat se si nxënësit e monitorojnë dhe drejtojnë me qëllim të nxënësve të tyre.

Vlerësimi i shokëve të klasës është kur nxënësit e marrin përgjegjësinë për vlerësimin e punës së bashkëmoshatarëve të tyre karshi kriterëve të përcaktuar të vlerësimit.

Mësimdhënia reaguese: është një mënyrë tjetër për të thënë vlerësimi formativ i ciklit të shkurtër.

Rubrika është një udhëzues që përdoret për ta vlerësuar performancën, një produkt ose një projekt. Zakonisht përfshin kriteret e performancës; dhe një shkallë vlerësimi (Shkëlqyeshëm, Mirë, Kënaqshëm, pakënaqshëm ose 1,2,3,4,5 ose A, B, C, D, E)

Vetë-vlerësimi: është kur nxënësit vlerësojnë vetveten. Ata mund t'i vlerësojnë veprimet e tyre, qëndrimin ose performancën e tyre.

Nxënësit e vetë-rregulluar: e kuptojnë dhe e kontrollojnë mjedisin e mësim-nxënies së tyre.

Aftësitë **vetë-rregulluese** përfshijnë përcaktimin e qëllimeve, vetë-monitorimin dhe vetë-nxënien.

Këshilli i nxënësve: është një grup i nxënësve të zgjedhur nga bashkëmoshatarët e tyre për të trajtuar çështjet që i shqetësojnë.

Kriteret e suksesit: është një listë e veçorive që mësimdhënësi dëshiron që fëmijët t'i përfshijnë në punën e tyre gjatë orës së mësimi.




Objektivi i të nxënit i punëtorisë:

Të kuptojnë se si ta zbatojnë të nxënit aktiv në shkolla.

Kriteret e suksesit të punëtorisë:

Pjesëmarrësit në punëtori do ta përshkruajnë se si t'i integrojnë strategjitë efektive të të nxënit aktiv në klasa.

Pjesëmarrësit në punëtori do të jenë në gjendje ta vlerësojnë të nxënit aktiv që zhvillohet në shkollën e tyre.



Udhëzuesi i trajnerëve për prezantimin e punëtorisë

Përmbajtja e punëtorisë	Trajneri ua shpërndan pjesëmarrësve përmbajtjen e punëtorisë. Afati kohor varet nga trajneri.
Objektivat e punëtorisë dhe kriteret e suksesit	Trajneri jua shpërndanë pjesëmarrësve objektivin e të nxëniet dhe kriteret e suksesit. Pjesëmarrësit reflektojnë mbi kriteret e suksesit në fund të punëtorisë.
Aktiviteti i fjalorthit	Trajneri e prezanton aktivitetin e fjalorthit dhe/ose jua paraqet pjesëmarrësve fjalët ngadalë ose i referon pjesëmarrësit tek materialet e punëtorisë që u janë shpërndarë.
Çfarë është të nxëniet aktiv?	Trajneri i prezanton sllajdet.
Aktiviteti i kujtesës	Trajneri ua tregon pjesëmarrësve sllajdet e aktiviteteve të të nxëniet aktiv për 60 sekonda. Pastaj, u jep pjesëmarrësve kohë që t'i shkruajnë në letër aktivitetet që i kanë mbajtur mend. Trajneri mund ta përsërisë këtë disa herë para se të fillojë me aktivitetin e diskutimit.
Pse duhet t'i përdorim strategjitë e të nxëniet aktiv?	Trajneri i prezanton sllajdet.
Diskutim mbi të nxëniet aktiv	Përgjigjet në këtë diskutim do të jenë subjektive. Vlen të theksohet se nxënësit që dëgjojnë në mënyrë pasive kanë më pak gjasa të mësojnë sesa nxënësit që janë mësuar t'i përdorin strategjitë e të nxëniet aktiv.
Diskutimi piramidë	Ky aktivitet mund të jetë i vështirë për ta përgatitur. Nëse salla e trajnimit është e madhe, pjesëmarrësit mund të qëndrojnë në dy rrethë koncentrik. Përndryshe, gjysma e pjesëmarrësve mund të qëndrojnë mbështetur për muri, ndërsa gjysma tjetër vendoset përballë tyre. Ky diskutim ka për qëllim që të tregojë se nuk ka justifikime të mira që të mos përdorën strategjitë e të nxëniet aktiv në çdo orë mësimi.
Aktivitetet e të mësuarit aktiv	Trajneri i prezanton aktivitetet.(këshillohet që pjesëmarrësit ta kenë një kopje të këtyre aktiviteteve)Trajneri mund t'u kërkojë mësime të mësuara që t'i ndajnë rastet kur i kanë përdorur këto aktivitete.

Udhëzuesi i trajnerëve për prezantimin e punëtorisë

<p>Aktiviteti lidhur me planin mësimor</p>	<p>Në një punëtori të shkurtër, vetëm pjesa 1 e aktivitetit do të mund të realizohet. Megjithatë, do të ishte më mirë nëse mësimdhënësit i ndajnë planet reale të tyre. Pjesëmarrësit mund të organizohen në grupe lëndore (p.sh. Mësimdhënësit e shkencave mund të punojnë së bashku. Mësimdhënësit e klasave të ulëta fillore mund të punojnë së bashku, etj.) Ky aktivitet mund të zgjerohet në një punëtori tjetër më të gjatë praktike e cila do të fokusohet në planifikimin e orës mësimore.</p>
	<p>Përgjigjet janë subjektive. Është me rëndësi që trajneri të theksojë se një orë mësimore e udhëhequr nga mësimdhënësi mund të jetë e suksesshme, por me rëndësi është që orët mësimore të udhëhequra nga mësimdhënësit t'i kenë të integruara strategjitë e të nxënësve aktiv.</p>
<p>Vlerësimi i aktiviteteve të të nxënësve aktiv</p>	<p style="text-align: center;">Trajneri i prezanton sllajdet.</p>
<p>Rubrika</p>	<p style="text-align: center;">Trajneri i prezanton sllajdet.</p>
<p>Aktiviteti i vlerësimit me rubrikë</p>	<p>Ky është një aktivitet i vështirë. Referoju pjesëmarrësit në rubrikën e të nxënësve bashkëpunues dhe kriteret e suksesit për njësinë mësimore. Përgjigjet janë subjektive. Ky aktivitet mund të shtrihet edhe në një punëtori të plotë ku mësimdhënësit krijojnë rubrika të përshtatshme për moshën për fushat e tyre lëndore.</p>
<p>Shembuj të praktikës së varfër pedagogjike</p>	<p>Trajneri i prezanton sllajdet. Trajneri mund të nxjerrë zgjidhje përpara se t'i ndajë ato me pjesëmarrësit.</p>
<p>Tejkalimi i barrierave në një shkollë me burime të pamjaftueshme</p>	<p>Trajneri i prezanton sllajdet. Çdo mësimdhënësi e ka vështirë ta tejkalojë këtë aktivitet. Trajneri duhet ta theksojë vështirësinë e këtij aktiviteti. Sllajdet prezantohen për të dhënë ide.</p>
<p>Aktiviteti i citimeve të nxënësve</p>	<p>Këto citate janë citime reale nga nxënësve. Trajneri duhet të përpiqet ta bëjë ndërlidhjen ndërmjet praktikës së dobët pedagogjike dhe rezultateve të nxënësve.</p>

Udhëzuesi i trajnerëve për prezantimin e punëtorisë

Diskutimi mbi praktikat më të mira	Në këtë diskutim nuk ka një përgjigje të vetme, por trajneri duhet ta theksojë rëndësinë e informatave kthyesë të nxënësve lidhur me mësimdhënien dhe mësim-nxënien që ata e përjetojnë.
Aktiviteti lidhur me idetë e orës mësimore	Më rëndësi është që pjesëmarrësit ta bëjnë një listë të shembujve konkretë. Pjesëmarrësit mund të ftohen t'i ndajnë këto ide në klasë. Trajneri mund ta shndërrojë këtë aktivitet në një aktivitet tjetër të rathëve të qepës.
Të nxënit digjital	Trajneri i prezanton sllajdet e të nxënit digjital. Trajneri mund t'i përdorë sllajdet për të gjeneruar diskutime lidhur me të nxënit digjital në kontekstin specifik të shkollës.
Aktiviteti me tekste shkollore	Ky aktivitet është përgatitur për t'i ndihmuar pjesëmarrësit në vlerësimin e teksteve shkollore. Është gjithashtu me rëndësi që pjesëmarrësit të jenë në gjendje t'i përshtatin tekstet shkollore për të pasqyruar pedagogjinë e bazuar në dëshmi. Ky aktivitet mund të zgjerohet në një punëtori individuale ku pjesëmarrësit i vlerësojnë një numër tekstesh shkollore dhe bashkërisht mendojnë për ide se si t'i përshtatin ato.
Definoni mësimdhënien dhe të nxënit e cilësisë së lartë	Trajneri e prezanton aktivitetin. Ky aktivitet mund të zgjerohet edhe më shumë. Ky aktivitet mund të zgjerohet në një punëtori të vetme ku e tërë shkolla mblidhet për të diskutuar/ndarë ide lidhur me definicionin e shkollës për mësimdhënie dhe mësim-nxënie të cilësisë së lartë.
Aktiviteti lidhur me vetë-studimin e shkollës.	Trajneri e prezanton aktivitetin. Ky aktivitet mund të shtrihet edhe në një punëtori të vetme. Nga stafi mund të kërkohet që ta zhvillojnë një vetë-studim të vogël për sa i përket cilësisë së mësimdhënies dhe mësim-nxënies në shkollë.
Reflektimi	Trajneri duhet t'u japë pjesëmarrësve kohë për të reflektuar dhe ndoshta për të marrë shënime personale për veten e tyre. Pjesëmarrësit duhet rikujtuar se reflektimi mbi të nxënit dhe përcaktimi i objektivave duhet të përfshihen gjithashtu në praktikën profesionale. Strategjitë e të nxënit të vetë-rregulluar kanë ndikim të rëndësishëm në rezultatet e nxënësve.



Kosovo Legal
Services Company



IBE



EDUCATIONAL
RESEARCH
INSTITUTE

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Projektit KosEd dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.